



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 206, datë 11.10.2019

PËR

**KOMANDIMIN E GJYQTARES RUDINA PALLOJ NË POZICIONIN E
KËSHILLTARIT LIGJOR NË NJËSINË MBËSHTETËSE TË KOMISIONEVE NË
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 53, 54 pika 5 dhe 6 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 104, datë 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtareve për komandim ne Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Komandimin e gjyqtares Rudina Palloj në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësine Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datën 21.10.2019.
3. Përfundimin e menjëhershëm të gjyqtares Rudina Palloj nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR